



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përherëshme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturale, Peizazh kulturor

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Manastiri i Graçanicës



**Datimi/et (Relativ/e)
Periudha/t historike**

Antik - Mesjetë

Adresa: Vendndodhja, Qyteti/Fshati, Komuna
*Komuna e Graçanicës 10500
Zona e KK Graçanica*

Lloji i asetit të propozuar

Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike

Nënkategoria: Monument /Ansambël

Numri unik

003343

Numri i regjistrimit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Mbrojtje tjetër: Vendimi 427/1947

Lista e Trashëgimisë Botërore e UNESCO-s / data e mbrojtjes: 2006

Zonë e Veçantë e Mbrojtur/ data e mbrojtjes: 2008

Nën Mbrojtje të përkohshme 2011, 2012, 2013, 2014, 2015

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Manastiri i Graçanicës, radhitet ndër objektet më të rëndësishme të arkitekturës në kulturën mesjetare të Evropës Juglindore. Në përbërjen e saj posedon të gjitha elementet karakteristike të shtresuara gjatë shekujve. Manastiri është rindërtuar nga mbreti Milutin në mes të viteve 1315 dhe 1321. Manastiri i sotëm është rikonstruktiv i shek. XIV i një kisha të mëhershme (kushtuar Virgjërës Maria), e cila është ndërtuar në themelet e një bazilike shumë më të hershme krishtere të besimit katolik, sipas të dhënave e ndërtuar gjatë shek. VI-të.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Vlerat historike: Manastiri i Graçanicës gjendet në bregun e majtë të lumit Graçanka, në jug të Prishtinës. Manastiri i sotëm është rikonstruktiv në shek. XIV i një kisha të mëhershme (kushtuar Virgjërës Maria), e cila është ndërtuar në themelet e një bazilike shumë më të hershme krishtere të besimit katolik, sipas të dhënave e ndërtuar gjatë shek. VI-të.

Manastiri i Graçanicës në vitin 2006 i është bashkangjitur Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Vlerat artistike: Manastiri i Graçanicës është ndërtuar nga shek. i VI-të dhe poashtu rindërtohet edhe në shek. XIII mbi rrënojat e bazilikës tre anijatëshe të kishës së mëhershme, Kisha e Virgjërës së Shenjtë.

Manastiri i Graçanicës sipas konceptit të saj hapësinor i takon tipit të kishave me pesë kupola mbi bazë katrore me kryq të brendashkruar, karakteristike për arkitekturën bizantine. Në eksterier është arritur një marrëdhënie ideale në proporcionet dhe volumnin e manastirit.

Ngritja graduale e harqeve dhe kupolave duke shkuar kah pjesët e sipërme si dhe ndarja e fasadës ballore në tri pjesë përmes harqeve, i japin kishës një harmoni të jashtëzakonshme dhe vlerë të veçantë arkitekturore.

Tamburi i kupolës kryesore është origjinal, mbi të takohen harqet, duke e theksuar kështu bazën katrore të kryqit të brendashkruar. Katër kupolat anësore ngrihen mbi tamburet mjaft të larta, të cilat e theksojnë vertikalen e ndërtesës, që nuk ishte karakteristike tipike e asaj periudhe.

Enterieri i manastirit është i pasur me afreske. Piktorët e famshëm nga Selaniku Mihajli dhe Evtihije i përfunduan afresket në kishën kryesore deri më 1321, prej të cilave njihen 'Cikli i Festave të Mëdha', 'Mundimet dhe Mrekullitë e Krishtit' dhe janë një nder më të njohurat. Përpos afreskeve të jashtëzakonshme të shek. XIV ekzonarteksi i manastirit përmban afreske shumë të çmuara post-bizantine të shek. XVI-të si dhe një thesar të ikonave të periudhave të mëvonshme prej të cilave më të rëndësishmet janë ikona e Jezu Krishtit dhe ajo e Virgjërshës Mari.

Vlerat shkencore: *Manastiri i Graçanicës në përbërjen e saj posedon të gjitha elementet karakteristike të shtresuara gjatë shekujve. Paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit dhe stabilitetit të strukturës. Në kontekstin arkitekturual përfaqëson evoluimin arkitektonik si dhe zhvillimor të zonës dhe me gjere që nga periudha mesjetare.*

Vlerat shoqërore: *Krahas vlerave historike, artistike, Manastiri i Graçanicës ka vlere të rëndësishme edhe në aspektin shoqëror. Ka qene dhe është vendtakim i qytetareve të cilët praktikojnë ritualet spirituale dhe fetare të komuniteteve.*


Vlerat shpirtërore: *Manastiri i Graçanicës është ndërtesë dhe simbol i identitetit fetar dhe kulturor të komuniteteve dhe konsiderohet si një prej monumenteve kryesore që identifikon Komunën e Graçanicës dhe Republikën e Kosovës.*

Propozuesi:


Institucioni:

*Instituti Arkeologjik i Kosovës,
Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë – Prishtinë,
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit*

Emri/Mbiemri: *Enver Rexha*

Nënshkrimi

Emri/Mbiemri: *Edona Durguti*

Nënshkrimi

Adresa dhe kontakti: *Rr. Agim Ramadani, 10,000 Prishtinë*

Tel: 038 244 501

Mob. +37749 448 297

Email: Enver.Rexha@rks-gov.net

Email: edona.durguti@rks-gov.net

Data :/...../.....

Bashkëngjitur: Lista e të dhënave dhe dokumentacioni

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt.../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Graçanica gjendet në Kosovë, tetë kilometra në juglindje nga Prishtina, në pjesën lindore të luginës së Kosovës, ku butësisht ngrihen shpatet e malit Veletin dhe ato më të pjerrta të malit Strazhevc, nga lumi Graçanka dhe në perëndim deri te lumi Graçanka. Ajo ndodhet në lartësinë mbidetare rreth 570m dhe është pjesë e një pellgu tektonik Veletin. Veletini dhe Maja e Mprehtë janë kupat e shuara vullkanike ku gjenden shkëmbinj të pasur me minerale. Lumi Graçanka i takon sistemit të lumit Sitnica. Në afërsi të fshatit gjendet liqeni artificial Badovc. Nga ky liqen me ujë të pijshëm furnizohen shumë vendbanime në Kosovën qendrore, duke përfshirë edhe Prishtinën, Graçanicën dhe zonat e tjera të banuara. Diga mbi lum është ndërtuar në periudhë prej vitit 1963 – 1966.

Në Kosovë, në epokën e hershme historike, kanë jetuar fisi i vjetër ballkanik, Dardanët / Ilirët. Në zonë gjendej qyteti Dardan - Ulpiana i cili është ngritur në kohën e sundimit të romakëve, ku kishte qeverisje, kushtetutë dhe ligjet e saj, ku qytetarët e saj kanë pasur të drejtën civile romake, madje edhe të drejtën për të votuar. Nuk ka dyshim se Ulpiana, si qytet vetëqeverisës në Perendorinë Romake, ishte zhvilluar në një qendër ekonomike dhe kulturore të asaj kohe, falë pozitës shumë të favorshme gjeografike në afërsi të gjetjeve të mineraleve të plumbit, zinkut dhe metaleve të çmuara (miniera e Novobërdës, Shashkoc dhe Janjevës). Në shekullin III, Ulpiana ka arritur kulmin e saj, madhësinë, bukurinë dhe lavdinë, e cila më të drejtë është quajtur QYTETI MADHËSHTOR - URBS SPLENDISSIMA. Në shek. VI pas dridhjes së tokës në vitin 518 qyteti shkatërrohet në përmasa të mëdha dhe rindërtohet në periudhën e perandorit Justiniani i I-rë (Perandori me origjinë Dardane) dhe merr emrin JUSTINIANA E DYTË – JUSTINIANA SECONDA.

Për herë të parë fshati Graçanicë përmendet në një letër të Papa Benediktit IX që ia dërgoi kryepeshkopit Marinin në vitin 1303. Në këtë letër përmendet famullia katolike Grazaniza. Emri i famullisë së përmendur, sigurisht, vjen nga emri i fshatit Graçanica në afërsi të cilit ishin kolonitë e Saksonëve (mjeshtrë gjerman të përpunimit të metaleve) dhe të minatorëve në arealin Novobërd - Janjevë. Graçanica përmendet edhe në statutin e mbretit Millutin të vitit 1321.

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Komuna e Graçanicës 10500

Komuna e Graçanicës është formuar në bazë të Ligjit për kufijtë administrativ komunal më 20 shkurt 2008. Komuna e Graçanicës zyrtarisht emërohet komunë nga data 29.12.2009, kur edhe është mbajtur mbledhja inauguruese e Kuvendit Komunal të Graçanicës.

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNewRef I)

N 42° 35' 54.30" E 21° 11' 35.74"

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Manastiri i Graçanicës gjendet në bregun e majtë të lumit Graçanka, ne Komunën e Graçanicës në jug të Prishtinës.

Perimetri i asetit të propozuar: *përafërsisht 0.0400 ha*
Zona rrethuese për mbrojtje/Buffer zone: _____ ha
Sipërfaqja totale: _____ ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- *Planet e situacionit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese P=1:500 dhe 1:200 (nëse është e aplikueshme).*
- *Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projeksioni, emri i pronarit dhe data.*
- *Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratigrafinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

Manastiri i Graçanicës është ndërtuar mbi rrënojat e kishës së vjetër të shekullit të XIII-te, Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, e cila është ndërtuar mbi rrënoja të një bazilike tre anijatëshe shume me te hershme, e ndërtuar qe nga shek. i VI- te.

Manastiri i Graçanicës sipas konceptit të saj hapësinor i takon tipit të kishave me pesë kupola mbi bazë katrore me kryq të brendashkruar, karakteristike për arkitekturën bizantine. Në eksterier është arritur një marrëdhënie ideale në proporcionet dhe volumin e manastirit.

Ngritja graduale e harqeve dhe kupolave duke shkuar kah pjesët e sipërme si dhe ndarja e fasadës ballore në tri pjesë përmes harqeve, i japin kishës një harmoni të jashtëzakonshme dhe vlerë të veçantë arkitekturore.

Tamburi i kupolës kryesore është origjinal, mbi të takohen harqet, duke e theksuar kështu bazën katrore të kryqit të brendashkruar. Katër kupolat anësore ngrihen mbi tamburet mjaft të larta, të cilat e theksojnë vertikalen e ndërtesës, që nuk ishte karakteristike tipike e asaj periudhe.

Enterieri i manastirit është i pasur me afreske. Piktoret e famshëm nga Selaniku Mihajli dhe Evtihije i përfunduan afresket në kishën kryesore deri më 1321, prej të cilave njihen 'Cikli i Festave të Mëdha', 'Mundimet dhe Mrekullitë e Krishtit' dhe janë një nder më të njohurat.

Përpos afreskeve të jashtëzakonshme të shek. XIV ekzonarteksi i manastirit përmban afreske shumë të çmuara post-bizantine të shek. XVI- te si dhe një thesar të ikonave të periudhave të mëvonshme prej të cilave më të rëndësishmet janë ikona e Jezu Krishtit dhe ajo e Virgjëreshës Maria.

Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Funksioni aktual: Ndërtesë kulturi e besimit Ortodoks që ka në funksion edhe ndërtesa tjera ekonomike.

Autoritetet përgjegjëse: ?

Pronësia: ?

Shfrytëzimi aktual: Ndërtesë kulturi ku predikohet liturgjia shpirtërore dedikuar religjionit.

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit

Restaurimi më i madh në manastir është bërë kah fundi i shek. XVI, ku të gjitha hapjet në narteksin e jashtëm janë murosuar dhe janë pikturuar afreske të reja. Manastiri pësoi dëme të mëdha gjatë fundit të shek. XVII, kurse midis dy Luftërave Botërore dhe më pas është rinovuar dhe pikturuar ndërkohë.

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

Vlerat historike: Manastiri i Graçanicës gjendet në bregun e majtë të lumit Graçanka, në jug të Prishtinës. Manastiri i sotëm është rikonstruktiv në shek. XIV i një kisha të mëhershme (kushuar Virgjërës Maria), e cila është ndërtuar në themelet e një bazilike shumë më të hershme krishtere të besimit katolik, sipas të dhënave të ndërtuar gjatë shek. VI-të.

Manastiri i Graçanicës në vitin 2006 i është bashkangjitur Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO.

Vlerat artistike: Manastiri i Graçanicës është ndërtuar nga shek. i VI-të dhe poashtu rindërtohet edhe në shek. XIII mbi rrënojat e bazilikës tre anijatëshe të kishës së mëhershme, Kisha e Virgjërës së Shenjtë.

Manastiri i Graçanicës sipas konceptit të saj hapësinor i takon tipit të kishave me pesë kupola mbi bazë katrore me kryq të brendashkruar, karakteristike për arkitekturën bizantine. Në eksterier është arritur një marrëdhënie ideale në proporcionet dhe volumin e manastirit.

Ngritja graduale e harqeve dhe kupolave duke shkuar kah pjesët e sipërme si dhe ndarja e fasadës ballore në tri pjesë përmes harqeve, i japin kishës një harmoni të jashtëzakonshme dhe vlerë të veçantë arkitekturore.

Tamburi i kupolës kryesore është origjinal, mbi të takohen harqet, duke e theksuar kështu bazën katrore të kryqit të brendashkruar. Katër kupolat anësore ngrihen mbi tamburet mjaft të larta, të cilat e theksojnë vertikalen e ndërtesës, që nuk ishte karakteristikë tipike e asaj periudhe.

Enterieri i manastirit është i pasur me afreske. Piktorët e famshëm nga Selaniku Mihajli dhe Evtihije i përfunduan afresket në kishën kryesore deri më 1321, prej të cilave njihen 'Cikli i Festave të Mëdha', 'Mundimet dhe Mrekullitë e Krishtit' dhe janë një nder më të njohurat. Përpos afreskeve të jashtëzakonshme të shek. XIV ekzonarteksi i manastirit përmban afreske shumë të çmuara post-bizantine të shek. XVI-të si dhe një thesar të ikonave të periudhave të mëvonshme prej të cilave më të rëndësishmet janë ikona e Jezu Krishtit dhe ajo e Virgjërës Mari.

Vlerat shkencore: Manastiri i Graçanicës në përbërjen e saj posedon të gjitha elementet karakteristike të shtresuara gjatë shekujve. Paraqet një dëshmi faktike për të zhvilluar studime shkencore rreth sistemit të ndërtimit dhe stabilitetit të strukturës. Në kontekstin arkitektural përfaqëson evoluimin arkitektonik si dhe zhvillimor të zonës dhe me gjere që nga periudha mesjetare.

Vlerat shoqërore: Krahas vlerave historike, artistike, Manastiri i Graçanicës ka vlere të rëndësishme edhe në aspektin shoqëror. Ka qene dhe është vendtakim i qytetareve të cilët praktikojnë ritualet spirituale dhe fetare të komuniteteve.

Vlerat shpirtërore: Manastiri i Graçanicës është ndërtesë dhe simbol i identitetit fetar dhe kulturor të komuniteteve dhe konsiderohet si një prej monumenteve kryesore që identifikon Komunën e Graçanicës dhe Republikën e Kosovës.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

-Ndërtesa në përgjithësi ka ruajtur formën dhe pjesë të shumta të materialit original dhe është në gjendje të mirë fizike.

-Nuk ka pasur faktorë ndikues pos adaptimeve dhe restaurimeve të kohëpaskohshme të cekura më lartë.

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- Fotografi dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).
- Kopje e Aktit të mëhershëm mbi statusin ligjor të asetit.
- **Shtojcë 1**, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- **Shtojca 2**, Planet e situacionit të asetit me shenjzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, $P=1:200$ dhe $P=1:500$, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.
- Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe dixhitale.
- Informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.
- **Shtojcë 3**: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në $P=1:200$, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: QRTK - Prishtinë

Hartuesit e formularit: Merita Gorani Bajri Ing.dipl. Ark.
Agim Halili Tek.ndert.-konzerv.

Personi i autorizuar:

Adresa dhe kontakti: rr. Ilir Konushevc

Data: .../.../.....

Nënshkrimi: